



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova



Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debat publik për Dëgjimet Buxhetore për vitin 2024 - Fshati Batllavë

Debati i parë publik me qytetarë për dëgjimet Buxhetore për vitin 2024 u mbajt në fshatin Batllavë. Në vazhden e këtij diskutimi hyn edhe projeksioni buxhetor për vitin 2025 dhe 2026. Në këtë diskutim publik pjesmarrës ishin Drejtori i Drejtorisë së Financave, Fatlum Osmani dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi.

Diskutimin e udhëhoqi Drejtori Osmani, të cilin e filloi duke paraqitur një rezymë të përgjithshme të buxhetit dhe limiteve buxhetore të cilat i ka Komuna e Podujevës, në bazë të qarkores së dytë buxhetore të pranuar nga ana e Ministrisë së Financave. Komuna e Podujevës ka një buxhet të përgjithshëm prej 31 milion e 43 mijë e 19 euro. Nga kjo shumë 16 milion e 518 mijë e 288 euro janë në kategorinë e pagave, 513 mijë euro janë shpenzime për komunalitë do të thotë, rrymë, ujë dhe mbeturina. 1 milion e 670 mijë euro janë në kategorinë e subvencioneve dhe 8 milion e 756 mijë e 231 euro janë buxhet i planifikuar për investime kapitale të Komunës së Podujevës.

Drejtori Osmani ka shtuar së gjatë muajit qershor është aprovuar edhe Korniza Afatmesme Buxhetore e cila është bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik lokal të Komunës së Podujevës, ku janë planifikuar edhe projektet prioritare të cilat Komuna e Podujevës planifikon t'i realizojë në këto tri vitet në vazhdim.

Gjatë viteve të fundit Drejtori Osmani theksoi se Komuna e Podujevës ka pasur prioritet disa fusha të cilat janë fokusi në investime, vlen të ceket edhe fusha e investimeve në arsim ku Komuna e Podujevës ka pasur një rritje të ndjeshme të buxhetit ku për investime kapitale mbi 15 herë është rritur buxheti, normalisht që buxheti i Komunës së Podujevës nuk është 15 fishuar, por si prioritet është marrë sektori i arsimit, ku ka ndërtim të objekteve të reja arsimore si dhe renovime dhe paisja e këtyre objekteve arsimore më gjërat të cilat iu nevojiten për zhvillimin e procesit normal mësimor.

Gjithashtu investimet edhe në fushën e shëndetësisë i cili ka qenë dhe vazhdon të jetë një sektor prioritar i Komunës së Podujevës, ku ka investime qoftë kapitale qoftë në furnizimin me medikamente apo mallra dhe shërbime të tjera për një funksionim normal të sistemit shëndetësor.

Ka një rritje edhe në fushën e subvencioneve ku nga 670 mijë euro subvencion të arsimit sa ka qenë ka arritur një buxhet me vlerë 1 milion e 670 mijë euro, që ka rezultuar në rritjen e të gjitha kategorive të subvencioneve. Dhe po ashtu ka një dyfishim po thuajse të subvencioneve në fushën e bujqësisë, ku nga 430 mijë euro në Kornizën Afatmesme Buxhetore i kemi të planifikuar 700 mijë euro.

Drejtori Osmani tha se arsyeja e këtij takimi është që kërkesat e qytetarëve të trajtohen dhe të shërbejnë dhe në fund Komuna të ketë një planifikim sa më të mirë të buxhetit, në të gjitha fushat, të bujqësisë, të arsimit, të kulturës dhe normalisht edhe kërkesat në fushën e infrastrukturës.

Drejtori Osmani i falenderoi për pjesmarrje dhe i ftoj për të marrë fjalën, duke theksuar se deri në fund të shtatorit mirëpritën qytetarët që ti paraqesin kërkesat e tyre në drejtoritë përkatëse, në mënyrë që ato të inkuadrohen në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Ndërsa Drejtori Selimi i fton qytetarët që të paraqesin kërkesat e tyre shqetësimet dhe pse jo edhe ankesat, dhe e kalon fjalën tek banorët.

Kryetar i fshatit Batllavë, Haki Statovci – si ankesë fillestare e ka se dy lagje në fshatin e Batllavës nuk kanë ujë të pijshëm, dhe propozon ndërtimin e dy pusetave dhe me ndihmën e pompave të ujit të furnizohen këta banorë me ujë të pijshëm. Në lagjen e ”Zymeraj” dhe lagjen e “Boshnjakëve”. Kërkesë tjetër është pastrimi i lumit të Batllavës i cili rrjeth nga liqeni i Batllavës, i cili është bërë dy herë por jo në mënyrë profesionale. Kërkon që kjo të futet në buxhetin e vitit 2024 se është me rëndësi vitale. Ankesë tjetër është edhe dështimi i rrejtit të kanalizimit i cili është në rrjetin e lumit batllava, dhe kërkon që të rinovohet sepse kundërmimi i erës është shumë i rënd. Ndërsa kanalizimi i cili vjen nga fshati Shajkoc deri në lagjen e “Hasasinanëve” dhe i gjithi derdhet në sipërfaqet e livadheve, të cilat mbeten të pa shfrytëzueshme. Kërkesa tjetër me rradhë është rregullimi i një parku në lagjen e “Statovcëve”, po ashtu është një burim theksoi ai tek varrezat e Shajkocit që rrjeth lirshëm dhe bënë dëme vetëm kur ka shumë reshje shiu dhe kërkohet intervenim ani pse jo i menjëhershëm. Ndërsa kërkesa ka edhe për rregullimin e rrugëve. Ndërsa thotë se të gjitha këto projekte do t’i vendos në letër dhe do t’i dërzoj në komunë. Ndërsa shton se komuniteti i ashkalive ka një kërkesë për shtrimin e një rruge.

Bislimi, banor i fshatit Batllavë - kërkesa fillestare e tij është që në qendër të Hani të bëhet një rreth, i cili është shumë i nevojshëm. Kërkesë e dytë është shtrimi i trotuareve tek lagjia “Zymerovit”, i cili shtë i nevojshëm për nxënësit dhe këmbësorët, dhe po ashtu trotuari nga Xhamia e deri tek “Statovci”. Kërkesë me rradhë është ndërtimi i qerdhës. Kërkesa tjetër është po ashtu pastrimi i lumit, dhe ndërtimin e shtratit të lumit. Dhe kërksa në vazhdim është ndërtimi i një shtëpie të Kulturës në fshatin Batllavë. Tjetra kërkesë është ndërtimi i një qendre sportive në fushën e Mullinit të lagjia e Boshnjakëve. Ndërsa kërkesa përfundimtare është që fshati i Batllavës të shpallet si zonë turistike. Dhe kërkon kontraktimin e një kompanie për pastrimin e varrezave të fshatit Batllavë.

Andi Hasani, banor i fshatit Batllavë – fjalën e tij e fillon me kërkesën për rregullimin e ujit të pijshëm si kërkesë shumë urgjente, ku nga 15 qershori e deri në fund të shtatorit lagjia nga Xhamia , dhe lagjia e Boshnjakëve kanë ujë të pijës, ndërsa faturohemi me çmime të njëjta, ndërsa propozon ndërrimin e gypit nga gypi kryesor deri tek kyqja e 4 gypave të tjerë. Kërkes tjetër është që të evidentohen pronat publi.ke që të ndërtohen hapsira publike.

Kryetar i fshatit Batllavë, Haki Statovci - Shpjegon se në vitin 2005 liqeni i Batllavës është shpallur park nacional, por ka mbetur një projekt i parealizuar.

Bislimi, banor i fshatit Batllavë – e përmend edhe një rrugë e cila është e pa asfaltuar, me gjatësi 300 – 400 metra, nga lagjia e “Govorëve” e deri “Nisusht”

Pjestarë i komunitetit ashkali në fshatin Batllavë – Kërkesë ka shtrimin e rrugës “Enver Maloku” dhe dy rrugët e ashkalive. Ndërsa kërkes tjetër është prona me kalu në emër të tyre , meqë ata jetojnë aty për më shumë se 200 vite.

Andi Hasani, banor i fshatit Batllavë – ka një kërkesë për shtrimin e një rruge me zhavor e cila ka dalje në fushat e banorëve të cilat nuk munden me i punu tokat për shkak të rrugës së keqe.

Pjestarë i komunitetit ashkali në fshatin Batllavë – kërkesë tjetër e ka edhe ndërtimin e një parku për moshuar e të rinjë për të kaluar kohën.

Bislimi, banor i fshatit Batllavë - përveç që kërkon një park ai kërkon edhe ndërtimin e një shtëpie për të moshuar.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi – shpjegimin për kërkesat e banorëve të fshatit e fillon me problemin me ujin e pijshëm, ku thotë se problem me ujë të pijshëm kanë edhe fshatrat të tjera, edhe qyteti i Podujevës, krejt kjo vjen si pasojë e vjetërsisë së gypave dhe si pasojë e kyqjeve ilegale të banorëve dhe rrjedhave të mëdha , mirëpo si Komunë tash e dy vite shpjegon Drejtori Selimi nuk janë kompetent për të ndërmarrë asnjë veprim qoftë për mirëmbajtje apo rregullim të rrjetit të ujësjellësit. Pasi që me një vendim nga Ministria ku të gjitha kompetencat për këto punë bien mbi përgjegjësinë e KRU Prishtina. Ndërsa është larguar edhe komplet buxheti i cili është paraparë për këtë qështje nga Komuna dhe i gjithi ka kaluar në kompetenca të KRU Prishtina. E gjitha që Komuna e Podujevës mundet me e ba është me kontakti me KRU Prishtina dhe me nënshkru memorandume bashkëpunimi, në aspekte nxitëse për t’u zhvilluar punë në Komunën tonë. Po ashtu Drejtori Selimi i sygjeron banorëve që për probleme të tyre t’i drejtohen KRU Prishtinës me shkrim, sepse më ne nuk kemi kompetenca. Madje probleme me ujësjellës kemi edhe në qytet, ku ka më shumë se një vit kur ka fillu rregullimi i një gypi furnizues nga lagjia e dëshmorëve e deri tek pishat te kisha, i cili ka mbet peng i pronave private. Ndërsa sqaron se edhe nëse kërkesat adresohen në Komunë, ato prap do të përcillen tek KRU Prishtina.

Ndërsa për problemi e pastrimit të lumit, Drejtori Selimi thotë se ka probleme me të gjith lumenjët në Podujevë, si me lumin llap që është më i madhi si me lumin Dumnica dhe lumin Kaçanoll, të cilët kanë shkaktuar probleme shumë të mëdha me vërshimet që nga fundi i vitit të kaluar. Mirëpo shumë lumenj të vogël kanë shkaktuar probleme më shumë se lumi Batllava, edhe pse si komunë kemi intervenuar dhe jemi munduar të bëjmë zgjedhjen e disa problemeve mirëpo mundësia për të zgjedhur këtë problem është shumë e vogël, sepse kërkon një kosto shumë të madhe buxhetore të cilin Komuna nuk mundet me e përballu. Mirëpo ne kemi bërë kërkesë në Ministri për të filluar një bashkëpunim për këtë projekt ku edhe Komuna do të participojë me një shumë të konsiderueshme. Ani pse nuk shihet shumë zgjidhje pastrimi dhe zgjerimi i lumit, pasi që rreth tij ka drunjë të ndryshëm që e kanë një efekt pozitiv që e mbrojnë shtratin e lumit, të cilët në rast të intervenimeve duhet larguar. Mirëpo ne jemi në diskutime të vazhdueshme me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, por që nuk dihet se kur do të realizohet ky projekt, i cili sipas analizave është 6 deri në 7 milion euro i kushtueshëm.

Meqë ende ka dëme të pakompenzuara nga vërshimet e fundit, prap Komuna e bënë vetëm vlerësimin e dëmeve dhe Ministria e bënë kompenzimin, pasi që zyra e Kryeministrit e bënë vlerësimin përfundimtar.

Sa i përket rrjetit të kanalizimit Drejtori Selimi shpjegon se ky është një projekt i nisur në vitin 2016, i cili ka qenë një nga projektet më të dështuara të Komunës, i cili kushton rreth 20 milion euro. Megjithatë faza e parë e këtij projekti i cili ka kushtuar 5.5 milion euro ka ardhur vetëm nga qyteti e deri në Lluzhan, dhe nga Batllava deri në Gerdoc. Është një prej projekteve më të mëdha në historinë e Komunës dhe më i rëndësishëm i cili e bënë komplet zgjedhjen e ujërave të zeza. Nuk është një projekt që zgjidhet shpejt por nuk do të thotë që do të marrë një kohë shumë të gjatë. Mirëpo ne jemi shumë të përkushtuar për ta zgjedhur këtë problem, ndërsa 3 milion euro është vlera e kontratës që pritet të nënshkruhet dhe të fillojnë punimet.

Sa i përket rregullimit të parkut tek Oda e Statovcëve, nuk ka nevojë të bëhen kërkesa pasi që ka hy në procedura ku ka me u rregullu me kupëza, është në vlerësim dhe pritet shumë shpejt me fillu punimet dhe me u rregullu si parking, sepse parku nuk është i paraparë me këtë projekt, por pritet në vitet e ardhshme.

Rregullimi i rrugës në lagjen e Ashkalive mundemi me e rregullu me kubëza sepse është një rrugë e shkurtër. Meqë edhe Ministri Elbert Krasniqi kemi bisedu dhe jemi dakorduar që t'i dërgojmë disa projekte për komunitetet jo shumicë, të cilat edhe i kemi dërguar ku janë paraparë edhe disa rrugë në Batllavë dhe në Orllan, që përfshinë një projekt me vlerë rreth 300 mijë euro.

Ndërsa tek pjesa ku përfundon rrjeti i kanalizimit të Shajkocit, gjinden dy gypa të gjerë njëri fekal e tjetri atmosferik që bashkohen dhe përfundojnë në fusha deri tek ura e Batllavës dhe vazhdon deri në lum, edhe kjo është përfshirë në projekt i cili ka një vlerë mbi 60 mijë euro. Është projekt i përbashkët me kolektorin e madh, të cilin po shpresojmë që duhet me u përfundu këtë vit.

Për rrethrotullimin te rruga Lluzhan Orllan që është rrugë regjionale dhe është në kompetencë të Ministrisë, ndërsa Komuna nuk ka të drejtë as përgjegjësi dhe as kompetencë as me mirëmbajt dhe as me ba ndryshime , madje edhe rruga që e lidhë me Shajkocin dhe vazhdon deri në qytet, krejt qka mundemi me ba është një ndriqim me shtylla të KEDS-it. Ndërsa thotë që kërkesën e banorëve mund t'a dërgojnë në Ministri

Shpjegimin për kërkesat e trotuareve Drejtori Selimi e fillon duke treguar se janë anashkaluar pakëz për shkak që është e lehtë me u ndërtu por e vështirë me u mirëmbajtë, dhe kosto më të madhe po ka mirëmbajtja sesa rregullimi, pasi që brenda një viti po mbulohet me bari. Mirëpo këtë problem po e zëvendësojmë me ndriqim publik. Në disa pjesë janë kryer punimet e në disa tjera do të fillojnë së shpejti. Megjithatë do të shqyrtojmë si mundësi.

Ndërsa për rregullimin e rrugëve me zhavor kemi nda në bazë të prioriteteve, ku ka hapsira më shumë të banuara.

Kryetar i fshatit Batllavë, Haki Statovci - ka edhe një kërkesë ku thotë se zyrra e vendit i ka dy zyre të cilat njëra është e thatë dhe kërkon që në kordinim me Kryetarin e Komunës bashkësia lokale ta ketë zyren e vetë ku bëhen kërkesat dhe prioritetet. Të vendoset edhe orari kur punohet dhe ish mbajtë rregull dhe rend më lehtë.

Drejtori i Drejtorisë së Financave, Fatlum Osmani – tha se shumica e projekteve janë në fazën e prokurimit e disa të tjera do të fillojnë në vitin 2024, mirëpo gjithmonë mundësitë janë më të kufizuara në raport me nevojat. Mirëpo do të mundohemi ato të cilat janë më të nevojshme të inkuadrohen në buxhetin e vitit 2024, por nuk ka mundësi të inkuadrohen të gjitha për shkak të kufizimeve buxhetore që ka Komuna e Podujevës.

Drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi – thotë se ndriqimi i rrugëve disa janë përfunduar e disa pritet të përfundohen së shpejti, nga Oda e deri te rruga kryesore, të cilat janë në projekt. Ndërsa për trotuar ku është e nevojshme kanë për tu ndërtuar, është paraparë një pjesë afër shkollës që ka me u ndërtu.

Sa i përket lirimit të pronave publike Drejtori Selimi i inkuadron banorët që të bëjnë kërkesa në Drejtorinë e Kadastrit në Komunë e cila mundet me marrë hapa së bashku me Drejtorinë e Inspeksionit për të liruar hapsirat e uzurpuara.

Ndërsa për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës në Batllavë Drejtori Selimi tha se do t’u adresojnë si kërkesë në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ndërtimi i fushave ose terreneve sportive mundet me u ekzekutu, edhe pse janë disa projekte të tilla në Komunën e Podujevës, besojmë që do të ketë të tilla edhe në Batllavë. Ndërsa pjesa afër murit të Batllavës është kërkuar nga Federata e Futbollit të Kosovës e cila ka premtuar se do ta bëjë kompleks sportiv.

Tek pjesa që Batllava amë u shpallë zonë turistike në vitin 2013, ka dalë një vendim tjetër që ka dalë nga qeveria në atë kohë në krye me ish - Kryeministër Hashim Thaqin i cili e ka nënshkruar, ku Batllavën e bënë zonë të mbrojtur që e ndanë në tri zona të mbrojtura. Në zonën 1 nuk lejon as një lloj aktiviteti, në zonën 2 nuk lejon ndërtime vetëm aktivitete të lira dhe në zonën 3 pjesë pjesë parasheh ndërtime, ky vendim qëndron në fuqi me disa amandamendime të lehta të cilat e lejojnë lundrimin dhe peshkimin. Kjo ka ndodhur për shkakë që uji i liqenit të Batllavës shfrytëzohet për ujë të pijshëm. Megjithatë të gjitha kompetencat për këtë qështje i ka Ministria, pasi që janë zona që mbrohen nga shteti.

Për pastrimin e varrezave nuk është që ka ndonjë projekt nga Komuna për këtë qështje, dhe është e vështirë të gjitha varrezat me u pastru nga Komuna.

Ndërsa problemin për rrugën nga lagjia “Govoret” deri tek lagjia “Nisusht” do t’u adresojmë tek Drejtoria e Planifikimit Urban e cila i ka asfaltimet.

Ndërsa shpjegimin e fundit Drejtori Selimi e dha për rrugët që po kërkohen të shtrohen me zhavor, ku tha se rrugët e banuara që nuk kanë asfalt janë të prioritizuara dhe pa u përfundu ato rrugët e pronave nuk mundën me u shtri.

Drejtori i Drejtorisë së Financave, Fatlum Osmani i falenderoi për pjesmarrjen dhe i falenderoi për bashkëbisedim, duke i inkuarjuar që gjatë kësaj faze t’i paraqesin kërkesat edhe me shkrim në mënyrë që ato të shqyrtohen dhe të futen në miratimin e buxhetit të vitit 2024, dhe disa edhe në vitet e ardhshme.

21 Gusht / Fshati Batllavë







11



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Dëgjim Publik në fshatin Batllavë për projekt buxhetin e komunës për vitin 2024 -
Lista e nënshkrimeve

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	HAKI STAVCI	BATLLAVË		
2	FASIL GOVORI	BATLLAVË		
3	BEISIM BAJRAKTARI	BATLLAVË		
4	Hamdi Hoxha	BATLLAVË		
5	BASRAM KOVALLI	BATLLAVË		
6	NEGJMEDIU HASANI	BATLLAVË		
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				